



Amfora

albaqeramika

Jemi evropianë

- Ja ku po vjen sérish stina e ftohtë. Është stina e dimrit kur ne kalojmë shumë më tepër kohë brenda se sa jashtë. Mirëpo, kjo stinë gjithsesi se e ka të vetën. Qëndrimi brenda na bën që ne të kemi më shumë kohë edhe për më të dashurit tonë, me të cilët edhe shënojmë festat e gëzueshme të fundvitit.

Gëzimet bëhen edhe më të mëdha dhe festat edhe më të ndritshme kur na vijnë edhe familjarët e miqtë që jetojnë në diasporë. Ata shfrytëzojnë pushimet në punë e shkolla për t'u bërë edhe një herë të gjithë bashkë ne ambientet e ngrohta familjare. Është kjo koha kur Evropa zbarkon në Kosovë dhe Kosova pa vërejtshëm bëhet pjesë e pandashme e Evropës. Kurse për rehatinë në ambientet familjare, natyrisht, se adresa është ALBAqeramika.

- Ne jemi përkujdesur që gjithmonë t'i bëjmë ambientet t'iu ngjajnë atyre në Evropë. Që kjo lidhje e Kosovës me Evropën të jetë edhe e dukshme. Kuzhinat dhe banjot me pllakat dhe sanitarinë e ALBAqeramikës janë ambienti evropian i shtëpive tonë. Po, evropianët meritojnë ambientet evropiane. Ne besojmë thellësisht se kosovarët janë pjesë kulturore e Evropës. Për këtë arsyë edhe familjarët kur na vijnë nga jashtë iu duket se vetëm janë bashkë me më të dashurit në një vend evropian.

Gëzuar festat për ju dhe familjarët tuaj. Faleminderit për besimin e vazhdueshëm.
ALBAqeramika do të jetë pranë jush edhe në 2017!

Gurë natyralë rrreth oxhakut tuaj

Një oxhak në shtëpi është dëshirë e secilit, sidomos kur vijnë muajt e fundit të vitit dhe bora mbulon tokën. Të rrish pranë zjarrit të oxhakut derisa shikon borën që lëkundet nga erërat e veriut është një ndjenjë e veçantë.

Ne në ALBAqeramika kemi menduar rrreth dekorimit të oxhakut tuaj dhe për këtë kemi krijuar bashkëpunim me kompaninë italiane të gurëve natyralë AlPetrica. Gurët nga AlPetrica mund të bëjnë që oxhaku juaj të ketë pamje të bukur, natyrale dhe të ngrohtë.



Guri SINTESIS



Në kuadër të serisë së veshjeve të mureve në gurë, ju paraqesim këtu SINTESIS që është një gur elegant natyral nga Sllovenia.

Me thjeshtësinë dhe integritetin që ka përshtatet në çdo hapësirë, si në moderne ashtu edhe klasike. Kjo pllakë vjen në format të madh 40x120 cm dhe është shumë e përshtatshme për të gjitha ambientet-ato komerciale apo banuese.

Ky gur është paraqitur edhe në ballinë.




ALBAqeramika ju uron festat e fundvitit

ALBAqeramika mike e SOS Fshatrave të Kosovës

Në fund të këtij viti ALBAqeramika me shumë kënaqësi përanoi ftesën e SOS Fshatrave të Kosovës për t'u bashkuar në programin "SOS Kompani Mike". Përgjegjësia sociale e kompanive vendore në fushën e përkrahjes së fëmijëve dhe të të rinjve pa përkujdesje prindërore do t'i ndihmojë SOS Fshatrave të Kosovës që ta plotësojnë misionin e tyre në krijimin e familjeve përfmijet nevojtarë. ALBAqeramika e konsideron shumë të rëndësishme përkrahjen e këtij misioni, duke u angazhuar që të ndihmojë ata të ndërtojnë të ardhmen dhe të marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre, sepse çdo fëmijë ka të drejtë të rritet me dashuri dhe respekt. Është qëllim yni i përhershëm që të përkrahim shoqërinë kosovare në fushat më të rëndësishme.

Këtë e kemi treguar me përkrahjen tonë disavjeçare në sport dhe kulturë.

SOS
KOMPANI
MIKE
E BRONZTË



Toalete fëmijësh

Në procesin e pavarësimit të fëmijëve është e rëndësishme që ata të kenë edhe guacën e tyre të toaletit. Duke pasur edhe ata një guacë të ngjashme me atë të të rriturve, bën që fëmijët të ndjehen të barabartë dhe të fillojnë të marrin përgjegjësi. Në ALBAqeramika mund të gjenden elemente toleti përfmijë si guaca, lavamane, bide etj. nga prodhuesi italian Galassia. Këto produkte mund t'i shtohen banjos suaj ekzistente, ose edhe të vendosen në një banjo krejtësisht të veçantë vetëm përfmijët.



ALBAqeramika ju uron festat e fundvitit



Festë gjithandej

Gjatë festave të fundvitit, përveç dhuratave dhe ushqimeve, rëndësi të veçantë kanë edhe dekoret. Biles dekoret e kanë barrën kryesore të krijimit të atmosferës festive. Bredhi, dritat, topat shumë ngjyrësh, figura të babadimrit e dordolecëve i jepin ambienteve tona një pamje krejt tjetër gjatë muajit të dhjetorit. Por zakonisht ne jemi mësuar të dekorojmë vetëm dhomën e ndejes. E pse të mos i dekorojmë edhe ambientet tjera? Pse të mos e dekorojmë edhe banjon? Kështu atmosfera festive do të na përcjellë në çdo kënd të shtëpisë.

